

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	I veshur si grua, 33-vjeçari 'tradhtohet' dhe arrestohet! Para agentëve bën dëshminë tronditëse për numrin e vrasjeve, i treti në histori
ADRESA	https://piranjat.al/bota/i-veshur-si-grua-33-vjecari-tradhtohet-dhe-arrestohet-para-agjenteve-ben-de-i104730
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 19:44:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 19:29:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7e7c2951776fdfb66b36c7fd6a55feaf7f5fda0397b2cbebd7447156f015d397
TEKSTI	efd97dbfcaa6809b4e90d5db6f1889f3abd326ef70b7635d3891c0378b7c993d
PAMJA	e8121ad3e39126e489da84a491efca346fdac8653a108d75832f96f64e462f1f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c0beca49f1b2de3bb498d852e662aa380fee2823da32148916173f7ec088bdb6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b36d3d1202e685b83ffcf611c8f22a5defe9644c370970134944b31e37e025b7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, në **radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c0beca49f1b2de3bb498d852e662aa380fee2823da32148916173f7ec088bdb6

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

[është kaq strategjike](#)

[Jemenit, në Gadishullin Arabik, dhe](#)

[1: Lironi çunat](#)

[në T. Pasi në këtë komisarjat mb](#)

[u godit banda e](#)

[e cila e kishte qendrën në Katalonia](#)

[represioni nuk na](#)

[kundër Ramës. Akt...](#)

[Arrestoni Ramën!](#)

[protestën e 1...](#)

[BOTA](#)

I veshur si grua, 33-vjeçari ‘tradhtohet’ dhe arrestohet! Para agjentëve bën dëshminë tronditëse për numrin e vrasjeve, i treti në histori

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 21:29



Ai pothuajse ia kishte dalë, por një tatuazh e tradhtoi. Jordan Lopes da Silva, 33 vjeç, ishte maskuar si grua, duke vendosur një paruke, syze dielli femrash dhe duke lyer thonjtë me manikyr. Në krahë mbante një fëmijë dyvjeçar, i cili nuk ishte i afërm i tij.

Me këtë maskim, ai tentoi t'i shpëtonte policisë braziliane, e cila ishte në gjurmët e tij prej 48 orësh, pasi dyshohej se kishte kryer 16 vrasje brenda një periudhe prej tre muajsh. Pasi kishte kaluar kontrollin, 33-vjeçari dyshohet se ishte kthyer në banesën ku fshihej, kishte marrë një pistoletë dhe kishte lënë fëmijën.

Por kur doli sërish nga banesa, veshja dyshohet se i ishte zhvendosur, duke zbuluar një tatuazh. Burri u arrestua në Mulumbu, në shtetin Paraíba, në pjesën verilindore të Brazilit. Bashkë me të u vunë në pranga edhe dy persona të tjerë, të dyshuar për përfshirje në disa vepra penale të kryera në zonë.

Rrëfimi tronditës

Pas arrestimit, 33-vjeçari bëri një rrëfim që i la agjentët të habitur; ai nuk kishte kryer 16 vrasje, por 80 gjatë gjithë jetës së tij, me vrasjen e tij të parë kur ishte vetëm 13 vjeç. Numri ende nuk është konfirmuar.

Hetuesit po kryejnë kërkimet dhe verifikimet e nevojshme, por nëse kjo shifër rezulton e vërtetë, ai do të jetë një nga vrasësit serialë me numrin më të madh të viktimave në botë, krahas mjekut anglez Harold Shipman, me 218 viktime, dhe kolumbianit Luis Garavito, i njohur si “Bisha”, të cilit i atribuohen 138 vrasje.

“Është një numër shumë i lartë. Besojmë se, edhe nëse nuk është saktësisht shifra e deklaruar, mund të jetë gjithsesi shumë pranë saj”, deklaroi kreu i hetimit, Douglas Garcia, për Globo.com. Deri tani, rezulton se Jordan Lopes da Silva ka kaluar gjithsej rreth gjashtë vjet pas hekurave dhe ishte liruar në maj të këtij viti.

Viktimat e mundshme

Mes krimeve që i atribuohen 33-vjeçarit është edhe vrasja e dy tregtarëve, të ekzekutuar më 1 gusht në Rio Tinto, në bregdetin verior të Paraíba-s. Sipas hetuesve, në pritën ndaj tyre dyshohet se kanë marrë pjesë edhe katër persona të tjerë.

Policia po verifikon gjithashtu përfshirjen e tij në vrasjen e një vajze të re. Trupi i viktimës dyshohet se u gjet pasi vetë 33-vjeçari u tregoi agjentëve vendin ku ishte varrosur. Ky është një element që hetuesit duhet ta krahasojnë me provat dhe të dhënat e tjera të mbledhura.

Autoritetet braziliane dyshojnë gjithashtu për një lidhje mes Lopes da Silva dhe një organizate kriminale të krijuar në Rio de Janeiro dhe që vepron në Paraíba.

Pasi i shpëtoi një ndërhyrjeje të mëparshme të policisë në Rio Tinto, burri dyshohet se u strehua në një komunitet në Cabedelo, në zonën metropolitane të João Pessoa-s, e konsideruar një nga bazat e këtij grupi kriminal. “Jam një njeri i mirë, nuk jam kërcënim për askënd”, deklaroi 33-vjeçari brazilian, duke pretenduar se kishte vrarë vetëm kriminelë dhe se donte të ‘pastronte shoqërinë’.

/PiranjatNews/

Artikuj te sugjeruar

[**“Eliminojeni pa lënë gjurmë”/ Historia e vrasjes së Georgi Markovit me çadrën e helmuar**](#)

Një nga vrasjet më të pazakonta politike të Luftës së Ftohtë ndodhi në Londër më 7 shtator 1978, kur shkrimtar...

BOTA 17 Shtator21:18

[**Çfarë është “Porta e Lotëve” dhe pse është kaq strategjike për botën?**](#)

Ku ndodhet Bab el-Mandeb? Ngushtica e Bab el-Mandeb ndodhet midis Jemenit, në Gadishullin Arabik, dhe brigjeve afrikane të Xhibutit dhe Eritresë...

BOTA 17 Shtator21:01

[**5 skenarë në lojë, Friedrich Merz rrezikon shkarkimin këtë fundjavë!**](#)

Kancelari gjerman Friedrich Merz përballlet me rrezikun e largimit nga posti që këtë fundjavë, vetëm 16 muaj pasi mori detyrën...

BOTA 17 Shtator20:53

[**Tensionet në ngushticën Bab al-Mandeb, Meloni urdhëron Marinën për mbrojtjen e anijeve italiane**](#)

Italia ka aktivizuar Marinën Ushtarake për të përgatitur masat e nevojshme për mbrojtjen e anijeve italiane që kalojnë në...

BOTA 17 Shtator20:01

[**OKB: SHBA ka të ngjarë të ketë kryer krime lufte në Iran, përfshirë shkollën në Minab**](#)

Një mision i pavarur faktmbledhës i mandatuar nga Kombet e Bashkuara ka arritur në përfundimin se ekzistojnë “baza të arsyes...

BOTA 17 Shtator19:29

[**Erdogan kërkon një mandat të ri presidencial? Çfarë thotë këshilltari i tij për zgjedhjet e parakohshme**](#)

Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan pritet të kërkojë një mandat të ri presidencial në zgjedhjet e parakohshme në Turqi, t&e...

BOTA 17 Shtator19:25

[**Zelensky ngre alarmin: 50 mijë trupa të Koresë së Veriut janë dërguar në Rusi!**](#)

Koreja e Veriut ka qenë një nga mbështetëset më të forta të Rusisë që kur ajo nisi pushtimin e plotë të U...

BOTA 17 Shtator19:18

[**Kritiku i hapur i presidentit Vladimir Putin gjendet i vdekur në një hotel në Portugali**](#)

Prokurorët në Portugali kanë hapur një hetim për vdekjen e një aktivisti ukrainas, i cili ishte një kritik i zëshëm...

BOTA 17 Shtator19:13

[**Banda e bankomatëve/ Nga bomba e tij u vra një grua 37-vjeçare, autori: Nuk është faji im që Maria humbi jetën! Më kontaktoi vetë se donte para**](#)

“Objekti i ishin bankomatet (ATM) dhe doja të merrja paratë. Nuk është faji im që ‘Maria’ u vra. Ajo u pagua për...

BOTA 17 Shtator18:05

[**Netanyahu zbulon planet e Izraelit: Do rrëzojmë regjimin e Iranit dhe do eliminojmë Hamasin e Hezbollahun!**](#)

Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu tha se Izraeli do të eliminojë Hamasin, do të mposhtë dhe rrëzojë regjimin e Iranit dhe ...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[**Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...**](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[**VIDEO- Dy aksidente me pesë viktime/ Prezantues...**](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

LIFESTYLE 16 Shtator

[**Prishtinë/ Shqiptarët protestojnë kundër vendim...**](#)

Ndërkohë që në rrugët e Prishtinës po zhvillohen protesta e tubime lidhur me vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës ...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59


[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pranë...

video




E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV






E premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.